

**ORGANI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT TË AKSIDENTEVE DHE  
INCIDENTEVE AJRORE NE AVIACIONIN CIVIL**




**Raporti Final – BLUE PANORAMA**



---

**RAPORTI PËRFUMDIMTAR**



**ORGANI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT TË AKSIDENTEVE DHE  
INCIDENTEVE AJRORE NE AVIACIONIN CIVIL**



**Raporti Final – BLUE PANORAMA**



## **Përbajtja**

- Informacione faktike
- Analizë e materialeve të mbledhura
- Rekomandime

**InD: Ing. Donatela Osmënaj**

**Asistoj: Ekspert i aviacionit Ylli Serjani**

## Raport "BLUE PANORAMA"

Më datë 16.06.2017 OKIIA mori informacion për disa raste të shhangjive në procedurat e operiminit ne aeroportin Nënë Tereza. Ky informacion i dërguar nga Albcontrol përbante 3 raste të shhangjive dhe shkelje të procedurave të operimit nga ana e kompanisë ajrore Blue Panorama. OKIIA me marrjen e këtij informacionifilloi procesin e investigimit i bazuar në kërkesat e mëposhtme për materialet në dispozicion:

- Kërkesë Albcontrolit për informacion më të detajuar për rastet duke përshfirë: përshkrimin e ngjarjeve, radiokomunikimin dhe transkriptimin e tyre ndërmjet kontrollorëve të trafikut ajror dhe pilotëve të fluturimeve përkatëse, skemat e fluturimeve sipas radarit, video të vendqëndrimit të avionëve dhe skemën e devijimeve të procedurës pas ngritjes.
- Kërkesë kompanisë ajrore Blue Panorama për vlerësimin e këtyre rasteve si dhe takim me drejtuesit e kompanisë ajrore Blue Panorama.

Pasi u grumbulluan materialet e mësipërme ato u studiuau nga OKIIA duke u mbështetur në procedurat standarte të ICAO-s, Aneksi 6 mbi operimin e avionëve, Aneksi 13 mbiinvestigimin e incidenteve dhe aksidenteve si dhe manualin e investigimeve për Runway Incursions dok.9870. U studiuau gjithashtu procedurat e SID dhe STAR ( për ngritje dhe ulje) në aeroportin "Nënë Tereza" dhe u arrit në konkluzionet si më poshtë:

Sipas kronologjisë së ngjarjeve rastii parështë aii dt. 03.01.2017. Ngritja në fluturim e avionit të BPA tip: Boing-737-800 me numër fluturimi BPA2331 me intinerar LATI-LIMC ( Tirana-Milano Malpence). Ky avion pasi mori leje për ndezjen e motorëve merr dhe lejen për të lëvizur në taxiway, ndërkokëti jepet dhe ATC clearance, e cila është lejimi për fluturim sipas rrugës së caktuar nga ATC ( Air Traffic Control). Piloti hyn në pistë dhe nuk ndalon për të kërkuar leje për ngritje pasi bën Back-Track ne runway 17, por vazhdon ngritjen. Ngritja vazhdon pa marr leje. Kontrollorii kullës e shikon dhe nuk e ndërpërt ngritjen që në momentet e para kur avionic s'ka fituar akoma shpejtësi, por pasi avioni ngrihet në ajër ai ndërhyn dhe i thotë që ju u ngritët pa leje dhe ikërkon të kontakojë me Approach të cilin gjithashtu e lajmëron që u ngrit pa leje. Piloti pranon që kishte bërë gabim duke u justifikuar me harresë dhe moskuptimin të mirë tëinstruksionit të dhënë. Në bazë tëinvestigimit të bërë konkludohet se:

1. Piloti në komandë dhe piloti dytë nuk kanë qenë të vëmendshëm për të marr dhe përsëritur korrekt instruksionin e kontrollorit të kullës, I cili thote: Lejohet per taxi për kursin 17, Back-Track dhe raporto gati për ngritje, instruksion të cilin nuk e zbatuan plotësisht duke mos thënë gati për ngritje.
2. Kontrollorii kullës nuk e ka detyruar pilotin të kthejë përgjigje si e kuptoi mesazhin: *Read Back Correct.*
3. Kontrollorii kullës nuk e ka ndjekur me vëmendje lëvizjen e avionit në taxi dhe pistë kur ai fillon vrapiimin për ta ndalur në kohë. Kjo vërtetohet dhe nga veprimi vonuar ikontrollorit kur i thotë pasi shtë ngritur që BPA2331 u ngritet pa marr leje.

4. Për të dy kategoritë Pilot-Kontrollor nuk ka patur vëmendjen e duhur për veprimet dhe pozicionet e avionit në cdo sekuencë të lëvizjes. Duke marrë parasysh konditat në të cilat ndodhi, në mungesë të trafiqeve të tjerë në afrim dhe në ulje kjo ngajrje nuk u klasifikua siincident. Duke parë edhe dy raste të tjera nga kjo kompani OKIIA investigoi dhe e analizoi atëpër rritjen e sigurisë së fluturimeve.

Ngjarja e dytë sipas informacionit të Albcontrol është ajo dt. 13.04.2017. Kjo ngjarje ishte një rast shumë serioz dhe e klasifikuar Runway Incursion në bazë të standardeve të ICAO-s. Kulla e Rinasit rrëth orës 09:40 lejoi ngritjen e një avioni BPA2233. Në të njëjtën kohë kontrollori Approach i kërkon kullës për të sjellë një avion të SwiftAir në ulje me RunWay 35, ndërkohë që ngritjet vazhdonin me RunWay 17. Kontrollori i kullës refuzon këtë kërkesë Approach-it pasi kishte dhënë leje BPA2247 për ndezje të motorëve dhe po i jepet lejen për të lëvizur në taxi. Ndërkohë duke menduar që për 3 minuta SwiftAir mund të ulejdhe kjo kohë duhej BPA2247 për të dalë në zonën e pritjes para hyrjes në pistë. Gjatë kësaj kohe kulla i thotë Approach-it që sille SwiftAir për ulje dhe i jep leje për ulje. Një tjetër avion BPA2231 kërkon leje për taxi, kulla i jep leje dhe e lajmëron që je i dyti për ngritje, por nuk vëzhgon lëzjen në taxi të avionit BPA2247 duke u përqëndruar vetëm në drejtimin e kundërt RunWay 35 i cili po ulej. Pra në të njëjtën kohë kontrollori kishte aktivitet në të dy kurset e pistës. Avionii kompanisë SwiftAir me numër fluturimi MDF9030 po ulej dhe duke parë avionin tjetër në kursin 17 pyet kullën a lejohet për ulje. Kontrollorii kullës duke mos ndjekur lëvizjen e BPA2247 i kthen përgjigje: "Lejoj uljen" (Clear to land). SwiftAir u ul, por duke bërë një frenim shumë të fortë, duke ndalur përpëra avionit që bëhej gati për ngritje në distancë 500 metër larg tij. Nga investigimi kësaj ngjarje e cila u konsiderua incident I kategorise RunWayIncursion, që ka ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave të operimit të sanksionuara në Aneksin 6 të ICAO-s për operimin e avionëve nga ana e ekuipazhit të fluturimit me numër BPA2247 dhe gjithashtu mos kryerja me përgjegjësi e detyrës nga ana e kontrollorit të kullës. Si konkluzion mund të rendisim konkretisht shkaqet si më poshtë:

1. Mos ndjekja me vëmendje e instruksionit të dhënë nga kulla dhe mos respektimit të rregullit përsëritjen e instruksionit të marrë.
2. Mos ndjekje e situatës ajrore nga pilotët nëpërmjet radiokomunikimit për të kuptuar dhe pozicionin e avionëve të tjerë se në çfarë procesi ndodhen.
3. Mos respektim i rregullit elementar nga pilotët për vrojtimin majtas dhe djathas përpëra daljes në pistë për ngritje.

Gjithashtu kjo situatë është favorizuar dhe nga faktorët e mëposhtëm:

1. Vendim igabuar nga kulla për të përdorur të dy kurset e pistës 17 dhe 35 dhe ndërhyja e kontrollorit Approach e shtoi më shumë konfuzionin në kullë.
2. Personeli në kullështë I mjaftueshmë për të ndjekur të dy avionët, njëri që dilte në pistë dhe tjetri që ulej përballë, por të dy u përqëndruan tek avioni që ulej.
3. Kulla nuk mori vendimin për të kaluar në rrëth të dytë avionin e SwiftAir qëishte në ulje.
4. Kontrollorët nuk kanë dhënë asnjë informacion trafiku si për avionin që po dilte në pistë ashtu dhe për avionin që po ulej.

Në radhën e ngjarjeve të informuar nga Albcontrol është ajo e datës 07.06.2017, e cila sërisht është një mosrespektim nga ana e kompanisë Blue Panorama BPA2227 të procedurës së ngritjes në aeroportin “Nënë Tereza”. Ky avion ishte planifikuar të fluturonte nga TIA në FCO (Tiranë-Romë) LATI-LIRF. Ekuipazhii përbërë nga 3 persona, first officer,kapiteni ciliishtë në rolin e instruktorit TRI/TRE si dhe observer, I cili ishte piloti përgjegjës për safety (safety pilot). Në orën 14:16 UTC këta kërkojnë leje për pistën 17 dhe vendosin të dhënat e fluturimit në FMS për këtë kurs. Gjatë lëvizjes nga vendqëndrimi kulla i ndryshon kursin e ngritjes nga 17 në 35 duke i dhënë pas ngritjes pikën Dires 2B (SID). Pas ngritjes ekuipazhi në vend që të kthehet djathas kthehet majtas. Kapiteni e dëgjoi kontrollorin që e pyeti pse u kthyet majtas duhej të kthehej djathas për Dires 2B. Atëherë kapiteni i cili e kuptoi menjëherë gabimin e korigjoi duke raportuar dhe duke thënë se kjo ndodhi gabimisht duke harruar instruksionin e dhënë nga ATC. Sipas investigimit qëiu bë këtij rasti rezulton se preqatitja e pilotit që trajnohej duhej të ndiqej me më shumë vëmendje nga pilotiinstruktor dhe aii safety për të korigjuar gabimet apo mungesat që mund të kryhen ose manifestohen nga piloti që trajnohet. Piloti që trajnohet duhet të përgatitet që para fluturimit për të kryer veprime në përputhje me cdo ndryshim që mund të kërkohet nga kontrollorët e kullës dhe të ATC, për cdo situatë e cila mund të jetë më e vështirë se ajo që i ndodhi BPA2227.

Si konkluzion për të 3 rastet të cilat u investiguan vërehet se nga kompania ajrore Blue Panorama, nga ekuipazhet fluturuese, ka mungesë serioziteti dhe vëmendje në respektimin e rregullave të operimit në aeroportin “Nënë Tereza” si dhe ndaj standarteve të ICAO-s për operimin e avionëve në përgjithësi. Në bazë të dokumentacionit qëOKIIApati në dispozion dhe investigimeve të bëra për të 3 këto ngjarje del një konkluzion i përgjithshëm si vijon:

*Në aeroportin Nënë Tereza nuk ka një trafik të ngjeshur si në Milano dhe Romë ku kompania Blue Panorama operon. Trafiku i pakët ka sjellë një shkujdesje në përqëndrimin e pilotëve dhe mobilizimin e tyre duke e konsideruar më të thjeshtë dhe më të lehtë operimin në këtë aeroport. Mungesa e vëmendjes dhe e kërkësës së rreptë kundrejt pilotëve nga ana e kontrollorëve të ATC-së dhe sidomos të kullës për një zbatim më rigoroz të rregullave dhe standarteve të operimit. Gjithashtu marrjen e masave ndaj të gjitha shkeljeve të kryera nga kompanitë ajrore që operojnë në aeroport dhe hapësirën ajrore që mbulon AlbControl. Duke u përqëndruar në qëllimin e këtij investigimi, i ciliështë rritja e sigurisë së fluturimeve rekomandojmë si më poshtë:*

- Kompanisë ajrore Blue Panorama t'i kërkohet përgatitje më serioze në trajnimeqë kryejnë me pilotët kur ata fluturojnë për në LATI ose nga LATI, që ato të respektojnë rregullat dhe procedurat e operimit. Albcontrol duhet të monitorojë më mirë lëvizjet e avionëve vecanërisht në tokë.
- Duhet një koordinim mëi mirë ndërmjet kontrollorëve të sektorëve të ndryshëm, kullë, Approach dhe ATC për të ndihmuar në përmirësimin e situatave të ngarkuara dhe jo për t'i komplikuar ato.
- ATC duhet të përcaktojë qartë pozicionin e dhënies se clearances (lejes) së fluturimit duke shhangur dhënien e lejes në momentet e kryerjes së taxi. Sugjerojmë që ajo të jepet kur jepet leje për ndezjen e motorëve apo kur jepet leje për taxi, pozicione në të cilat pilotiështë mëi lirë në veprime.
- ATC në kordinimin me drejtuesite aeroportit të vendosin shenja para daljes në pistë në mënyrë që piloti të përqëndrohet më mirë para daljes në pistë për të evitar RunWayIncursion.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### ORGANI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT TË INCIDENTEVE DHE AKSIDENTEVE AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL

Nr. prot. 55

Tiranë 21/06/2017

Drejtuar: Znj. Belina Balluku  
Drejtore e Përgjithshme  
Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror

Lënda : Memorandum i bashkëpunimit OKIIA-Albcontrol

E nderuar znj. Balluku,

Në përgjigje të shkresës suaj nr. prot. 1161 ju informojmë se bordi OKIIA-s do të analizojë të 3 rastet e evidentuara nga ana juaj. Për këtë kërkojmë nga ana juaj:

- Kopje të dokumentave dhe detajet e ekuipazhit të avionit
- Transkriptet e komunikimeve TWR - Pilot ACC - Pilot


Sa më sipër i kërkojmë për të 3 rastet.

Specifikojmë për rastin e fundit, dt. 07/06/2017 kërkojmë të paraqitur grafikisht rrugën që avioni ka ndjekur dhe rrugën që duhet të ndiqte sipas procedurave standarte. Nëse është e pamundur grafikisht, ju lutemi paraqiteni analistikisht ( koordinata dhe orë ).

Duke iu falenderuar për bashkëpunimin,

Me respekt

Dipl. Ing. Arben Xhiku  
Drejtore e Përgjithshme





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### ORGANI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT TË INCIDENTEVE DHE AKSIDENTEVE AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL

Nr. prot. 66

Tiranë 23/06/2017

Drejtar: Lilika Radovicka  
Drejtore Ekzekutiv  
Autoriteti Aviacionit Civil

Lënda : Kërkohet informacion për BLUE PANORAMA

E nderuar znj. Radovicka,


Në vijim të një emailli të nisur nga AlbControl mbi një ngjarje të ndodhur në aeroportin e Rinasit ( ngjarje e përsëritur ), lidhur me kompaninë BLUE PANORAMA, OKIIA ka vendosur hapjen e investigimit për këto ngjarje. Për këtë ju lutemi na mundësoni informacionet tuaja mbj kompaninë:

- Çertifikata e operatorit ajror
- Liçensat për personelin/anëtarët e ekuipazhit të lëshuara ose të pranuara nga ju
- Çertifikatat dhe liçensat e trafikut për avionët e BLUE PANORAMA

Duke iu falenderuar për bashkëpunimin,

Me respekt

Dipl. Ing. Arben Xhiku  
Drejtore i Përgjithshëm



~~A. Osmani~~  
~~Al. Shkembi~~  
~~Nr. prot. 1161/2~~  
~~03.07.17~~

~~Drejtuar:~~

**Z. Arben Xhiku**  
**Drejtor i Përgjithshëm**  
**Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore**  
**në Avacionin Civil**

Tiranë 30 6/2017

**Lënda:** **Kthim përgjigje**

Inderuar z. Xhiku,

Në përgjigje të shkresës suaj nr.55, datë 21.06.2017, ju informojme si më poshtë:

Përsa i përket kërkesës së parë pér kopje të dokumentave pér të tre ngjarjet po ju dërgojmë bashkangjitur raportimet e bëra nga kontrollorët e Kullës së Aerodrmomit të Rinasit, raportime që janë nisur pranë jush edhe nëpërmjet skemës së detyrueshme të raportimit të ngjarjeve siç kërkohet në Urdhërin e MTI nr. 68, datë 10.06.2011. Përsa i përket të dhënavë të ekkipazhit, ju informojmë se Albcontrol nuk disponon të dhëna të tillë dhe nuk ka mundësi të gjej këtë informacion.

Përsa i përket kërkesës së dytë ju informojmë se pér ngjarjen e datës 03.01.2017 transkripti i komunikimit është i pamundur t'ju dërgohet pasi është jashtë periudhës së kërkuar pér ruajtjen e këtyre komunikimeve. Megjithatë Albcontrol ka kryer një vlerësim paraprak të kësaj ngjarje të cilin po jua dërgojmë bashkangjitur.

Përsa i përket ngjarjes së datës 13.04.2017 transkripti i komunikimit së bashku me raportin e investigimit, është dërguar pranë jush me email në datën 19.06.2017, megjithatë po jua ridërgojmë bashkangjitur kësaj shkrese.

Pér ngjarjen e fundit të datës 07.06.2017, bashkangjitur po ju dërgojme transkriptin e komunikimit së bashku me paraqitjen grafike të rrugës së përshtkuar nga piloti dhe asaj që ishte udhëzuar nga kontrollori i trafikut ajror.

Edhe njëhere ju shprehim gatishmërinë tonë për përbushjen e vazhdueshme të kërkesave rregullative me qëllim shmangjen e ngjarjeve që cënojne sigurinë e fluturimeve në hapsirën Ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt,

**Belinda Balluku**

Drejtore e Përgjithshme





National reference number

### ATC Occurrence Reporting Form

CATEGORIES OF OCCURRENCE											
<input type="checkbox"/> ACCIDENT	<input type="checkbox"/> AIRPROX	<input type="checkbox"/> INCIDENT	<input type="checkbox"/> AIRSPACE INFRINGEMENT	<input checked="" type="checkbox"/> ATM OCCURRENCE							
NB A signal shall be sent to the Head of ATM Oversight for ACCIDENT or AIRPROX											
1 Date / Time (in UTC) of Occurrence		2 Day or Night		3 Geographical Location of Occurrence							
03.1.2017		05:47		<input checked="" type="checkbox"/> Day	<input type="checkbox"/> Night	LATI					
4 Aircraft Involved											
Operator	Callsign and/or Registration	Type	ADEP	ADES	FL, Altitude or Height		SSR Code	Mode C displayed	Relevant Route Segment	Fit Rules	
					Actual	Cleared					
BLUE PANORAMA	BPA2331	B734	LATI	LIMC				N/A	N/A	<input checked="" type="checkbox"/> IFR <input type="checkbox"/> VFR <input type="checkbox"/> SPEC	
								N/A	N/A	<input type="checkbox"/> IFR <input type="checkbox"/> VFR <input type="checkbox"/> SPEC	
5 RTF Frequencies/Communications Equipment and Surveillance Equipment used					6 Class of ATS Airspace		7 Type of Air Traffic Services				
122.5					<input type="checkbox"/> A	<input type="checkbox"/> B	<input type="checkbox"/> C	ADITWR			
					<input checked="" type="checkbox"/> D	<input type="checkbox"/> E					
8 Estimated Vertical Distance (ft/metres)					9 Automated Warning Systems						
Estimated Horizontal Distance (NM/km/minutes)					<input type="checkbox"/> Ground-based <input type="checkbox"/> N/A <input type="checkbox"/> Airborne						
N/A											
10 Traffic Information given					11 Have you reviewed relevant RTF and/or surveillance recordings?						
<input type="checkbox"/> YES <input type="checkbox"/> NO					<input type="checkbox"/> YES <input checked="" type="checkbox"/> NO						
12 Was Weather considered relevant? (If YES, include details in Box 13)					<input type="checkbox"/> YES <input checked="" type="checkbox"/> NO						
Description of Occurrence –  Me date 3 janar 2017 ora 0540 BPA2331 pasi mori lejen per tu futur ne piste, pasi imbaroj proceduren e "back track" filloj rulimin dhe beri "air born" pa i dhene teje per "take off". Nuk afektoj ne trafikun qe kishim. Ju be e ditur pilotit dhe kontrollorit te Aproach.											
14 Assessment of Workload					15 Time since last break		16 Start Time of Shift		17 Name of your ATS Unit and Sector Safety Directory		
<input type="checkbox"/> Very Heavy		<input type="checkbox"/> Medium				<input checked="" type="checkbox"/> UTC	<input type="checkbox"/> Local	Sektori i TWR			
<input type="checkbox"/> Heavy		<input checked="" type="checkbox"/> Light				0300					
18 On Duty as		19 Your Name, Signature and Date		For ATM Oversight use ONLY -							
<input checked="" type="checkbox"/> ATCO <input type="checkbox"/> Shift Supervisor											

Dërgoni formën:

## PERMBLEDHJE INVESTIGIMI

### Mbi devijimin e avionit nga leja e dhene nga KTA, data 03.01.2017

Në bazë të të dhënave të mbledhura dhe analizuara kemi një përshkrim të shkurtër të ngjarjes si vijon.

Në datën 03 Janar 2017, rreth orës UTC 05:45, BPA2331 i ka kërkuar leje TWR për të lëshuar motorët për fluturimin me numër BPA2331. Ky fluturim kishte Plan Fluturimi të rregullt, pa asnjë kufizim të posaçëm.

Pas marrjes së kërkesës nga BPA2331, TWR KTA (Kontrollori i Trafikut Ajror) i jep lejen për ndezjen e motorëve dhe koordinon rregullisht me Sektorin Approach dhe Pilotin për t'i shërbyer ngritjes së BPA2331. BPA2331 pas kërkesës, merr lejen për të lëvizur (Taxi) si dhe i jepet ATC Clearance për destinacionin Milano (LIMC).

Piloti pas komunikimeve me KTA TWR futet në RWY17 dhe fillon dhe ekzekuton manovrën e ngritjes (Take-Off) pa marrë lejen përkatëse (të detyrueshme) nga TWR KTA.

TWR KTA pavarësisht se vuri re se BPA2331 po ekzekutonte Take-Off pa marrë leje, nuk ndërhyri për ta ndaluar, pasi kjo manovër nuk ndikonte mbi asnjë trafik tjetër. Pas ngritjes në ajër të BPA2331, TWR KTA e informon Pilotin se e kishte kryer manovrën e ngritjes pa autorizimin përkatës nga TWR, dhe më tej e instruktoi të kalonte me frekuencën e Approach (133,150). TWR KTA vuri re (ose mendoi) se Piloti i BPA2331 nuk e kishte kuptuar informacionin që i kishte transmetuar, dhe për të qenë i sigurt që gjithçka ishte në rregull me BPA2331 i kërkon Approach që t'ia bëjë të ditur faktin BPA2331 dhe të konfirmojë nëse fluturimi shkon mirë dhe se ngritja pa autorizim kishte ardhur vetëm si pasojë e harresës nga ana e Pilotit.

BPA2331 kishte konfirmuar për Approach se ngritja pa autorizim kishte ardhur për shkak të harresës dhe/ose miscommunication.

### Konkluzione:

1. BPA2331 nuk ka zbatuar ATC Procedures, të cilat kërkojnë që Piloti duhet të mare një leje/autorizim të posaçëm nga TWR ATCO me anë të radios për të filluar manovrën e ngritjes;
2. TWR ATCO ka ndjekur me kujdes zhvillimin e ngjarjes dhe ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të verifikuar që kjo ngjarje u shkaktua nga një haresë e Pilotit dhe nuk kishte probleme të tjera në lidhje me këtë ngjarje.
3. Në bazë të Manualit të Safety, nuk është e nevojshme të kryhet investigim i mëtejshëm, për këtë ngjarje.



National reference number

### ATC Occurrence Reporting Form

CATEGORIES OF OCCURRENCE										
<input type="checkbox"/> ACCIDENT	<input type="checkbox"/> AIRPROX	<input checked="" type="checkbox"/> INCIDENT	<input type="checkbox"/> AIRSPACE INFRINGEMENT	<input type="checkbox"/> ATM OCCURRENCE						
NB A signal shall be sent to the Head of ATM Oversight for ACCIDENT or AIRPROX										
1 Date / Time (in UTC) of Occurrence 13.04.2017 09.55		2 Day or Night <input checked="" type="checkbox"/> Day <input type="checkbox"/> Night		3 Geographical Location of Occurrence						
4 Aircraft Involved										
Operator	Callsign and/or Registration	Type	ADEP	ADES	FL. Altitude or Height		SSR Code	Mode C displayed	Relevant Route Segment	Fit Rules
					Actual	Cleared				
BLUE PANORAMA	BPA2247	734	LATI	LIME						<input checked="" type="checkbox"/> IFR <input type="checkbox"/> VFR <input type="checkbox"/> SPEC
SWIFTAIR	MDF9030	5W4	LGT	LATI						<input checked="" type="checkbox"/> IFR <input type="checkbox"/> VFR <input type="checkbox"/> SPEC
5 RTP Frequencies/Communications Equipment and Surveillance Equipment used					6 Class of ATS Airspace		7 Type of Air Traffic Services			
					<input type="checkbox"/> C	<input checked="" type="checkbox"/> D				
					<input type="checkbox"/> G					
8 Estimated Vertical Distance (ft/metres)					9 Automated Warning Systems					
Estimated Horizontal Distance (NM/km/minutes)					<input type="checkbox"/> Ground-based	<input type="checkbox"/> N/A	<input type="checkbox"/> Airborne			
10 Traffic Information given					11 Have you reviewed relevant RTF and/or surveillance recordings?					
<input type="checkbox"/> YES		<input type="checkbox"/> NO			<input type="checkbox"/> YES	<input checked="" type="checkbox"/> NO				
12 Was Weather considered relevant? (If YES, include details in Box 13)										
Description of Occurrence – Ne oren 09:51 MDF 9030 ju dha leje par uje me RWY35, ndekohë qe BPA 2247 mori laci clearance ne oren 09:52 per RWY17. Ne oren 09:53 qe BPA 2247 kishte hyre ne taxiway E mori ATC clearance, ne ato momente MDF9030 ishte ne finale shume shume te shkurtër dhe pas pak sekondash degjohen qe piloti i MDF 9030 qe ne ate moment ishte mbi threshold duke konfirmuar "clear to land swiftair", the aty pashe BPA2247 qe kishte futur hunden ne piste. Piloti i MDF9030 ndofte urgjent na distanca shume te shkurtër dhe nuk pati rezik nga momenti qe preku ne toke. BPA nuk kishte marr leje per te hyre ne piste 17, kur u pyet piloti pse kishte hyre ne piste na raportoi qe kishte keqkuptuar clearance. Trafiku vazhdoi normalisht pas kesaq ngjarje.										
14 Assessment of Workload			15 Time since last break		16 Start Time of Shift		17 Name of your ATS Unit and Sector Safety Directory			
<input type="checkbox"/> Very Heavy <input checked="" type="checkbox"/> Medium <input type="checkbox"/> Heavy <input type="checkbox"/> Light			0900		<input checked="" type="checkbox"/> UTC	<input type="checkbox"/> Local	Sektori i TWR			
18 On Duty as <input checked="" type="checkbox"/> ATCO <input type="checkbox"/> Shift Supervisor		19 Your Name, Signature and Date		For ATM Oversight use ONLY:						

In case of accident, serious incident etc.

In case of other Occurrences

## Informacion per OKIIA

**Transkripti i komunikimit midis kontrolloreve te trafikut ajror dhe pilotit te Blue Panorama ne daten 13.04.2017**

Transkript i komunikimit 13 Prill 2017 RI MDF9030 / BPA2247			
09:51:30	MDF9030	TWR	Tirana TWR, MDF9030, One Zero Miles Final, RWY35.
09:51:39	TWR	MDF9030	MDF9030, TWR, Good Day, Cleared to Land RWY35, Wind Two Six Zero Degrees, Four Knots. QNH1012.
09:51:47	MDF9030	TWR	One Zero One Two, Cleared to Land RWY35, MDF9030.
09:51:57	BPA2235	TWR	Tirana TWR, Good Day, BPA2235, We are at Stand Tango 9, Request Start up Clearance.
09:52:03	TWR	BPA2235	BPA2235, Start Up approved, RWY17, Information Whiskey, QNH 1012.
09:52:10	TWR	APP	Me mua është, ...
09:52:12	APP	TWR	Jo s'ka problem, i ke released sipas rrades njeri pas tjetrit.
09:52:15	TWR	APP	Ok, te kuptova.
09:52:25	BPA2247	TWR	Tirana, BPA2247, Request Taxi!
09:52:30	TWR	BPA2247	BPA2247, Taxi to Holding Point RWY17 Via Echo (E)
09:52:34	BPA2247	TWR	To Holding Point One Seven Via Echo, BPA2247.
09:53:26	BPA2341	TWR	Tirana, BPA2341, Ready to Taxi, Tango 10.
09:53:33	TWR	BPA2341	BPA2341 Taxi to Holding Point RWY17 Via Echo, Number Two for Departure.
09:53:43	BPA2341	TWR	Via Echo, Number two for departure, BPA2341.
09:53:49	TWR	BPA2247	BPA2247, Cleared to Torino via Dires2 Alpha, Climb Flight Level 180, Squawk 1373

09:53:57	BPA2247	TWR	Cleared to Destination, Torino, Via Dires 2 Alpha Departure, Squawk 1373, BPA2247.
09:54:06	TWR	BPA2247	BPA2247 Read Back is Correct.
09:54:54	MDF9030	TWR	Cleared to Land Swift air?!
09:55:00	Unknown (Ndonje BPA)	TWR	Two Tree Five
09:55:01	TWR	BPA2247	2247 you didn't have any Clearance for Line-up, Sir.
09:55:06	BPA2247	TWR	Uhhh, Sorry, our mistake. It was uuuhhhhh.. misleading ... Sorry.
09:55:10	TWR	MDF9030	9030, Confirm?
09:55:15	MDF9030	TWR	Ok, Full speed ... control speed. MDF9030.
09:55:18	TWR	MDF9030	MDF9030, TWR.
09:55:26	BPA2247	TWR	Sorry Sir, we copied Line-Up – Back-Track uuhhh, BPA2247.
09:55:30	TWR	BPA2247	Negative Sir, you just took the Clearance, for your ATC Route, not to Line-up-Back-track.
09:55:37	BPA2247	TWR	Ok, Sorry, Really sorry. What can we do?



National reference number

### ATC Occurrence Reporting Form

CATEGORIES OF OCCURRENCE										
<input type="checkbox"/> ACCIDENT	<input type="checkbox"/> AIRPROX	<input type="checkbox"/> INCIDENT	<input type="checkbox"/> AIRSPACE INFRINGEMENT	<input type="checkbox"/> ATM OCCURRENCE						
NB A signal shall be sent to the Head of ATM Oversight for ACCIDENT or AIRPROX										
1 Date / Time (in UTC) of Occurrence 07.06.17 1450UTC			2 Day or Night <input checked="" type="checkbox"/> Day <input type="checkbox"/> Night		3 Geographical Location of Occurrence					
4 Aircraft Involved										
Operator	Callsign and/or Registration	Type	ADEP	ADES	FL, Altitude or Height		SSR Code	Mode C displayed	Relevant Route Segment	Fit Rules
					Actual	Cleared				
BPA	BPA2227	B734	LATI	LIRF	1700ft	FL180	1367	Yes		<input checked="" type="checkbox"/> IFR <input type="checkbox"/> VFR <input type="checkbox"/> SPEC
										<input checked="" type="checkbox"/> IFR <input type="checkbox"/> VFR <input type="checkbox"/> SPEC
5 RTF Frequencies/Communications Equipment and Surveillance Equipment used					6 Class of ATS Airspace		7 Type of Air Traffic Services			
					<input type="checkbox"/> C	<input type="checkbox"/> D				
					<input type="checkbox"/> G					
8 Estimated Vertical Distance (ft/metres)					9 Automated Warning Systems					
Estimated Horizontal Distance (NM/km/minutes)					<input type="checkbox"/> Ground-based <input type="checkbox"/> N/A <input type="checkbox"/> Airborne					
10 Traffic Information given					11 Have you reviewed relevant RTF and/or surveillance recordings?					
<input type="checkbox"/> YES <input checked="" type="checkbox"/> NO					<input type="checkbox"/> YES <input checked="" type="checkbox"/> NO					
12 Was Weather considered relevant? (If YES, include details in Box 13)										
Description of Occurrence -  BPA2227 mbas ngriljeve me piste 35 ,nuk zbatoi proceduren standarte per ngrilje Dires 2b ,per te cilien ishte instruktuar ,por pas ngriljeve u ktheje majtas duke thyer proceduren standarte.Pasi njoftuam approach na u tha nga kontrollori se kishte qene gabimi i pilotit qe ishte kthyer direkt dhe se piloti ishte i vetedishem per kete gabim.										
14 Assessment of Workload					15 Time since last break		16 Start Time of Shift		17 Name of your ATS Unit and Sector Safety Directory	
<input type="checkbox"/> Very Heavy		<input type="checkbox"/> Medium				<input checked="" type="checkbox"/> UTC	<input type="checkbox"/> Local	Sektori i TWR		
<input type="checkbox"/> Heavy		<input checked="" type="checkbox"/> Light								
18 On Duty as <input type="checkbox"/> ATCO <input checked="" type="checkbox"/> Shift Supervisor		19 Your Name, Signature and Date		For ATM Oversight use ONLY						

In case of accident, serious incident etc.


In case of other Occurrences

## Informacion per OKIIA

**Transkripti i komunikimit midis kontrolloreve te trafikut ajror dhe pilotit te Blue Panorama ne daten 07.06.2017**

Transcript BPA2227 Turning Left in VMC without ATC Clearance Date 07:06.2017				
Time	Station Calling	Station receiving	Message	Comment
14:46:10	TWR	BPA2227	BPA2227 Cleared to LIRF Via DIRES2B Departure, Climb FL180, Squawk 1367	
14:46:23	BPA2227	TWR	Cleared to LIRF, VIA DIRES2B, FL180, Squawk 1367, BPA2227	
14:46:31	TWR	BPA2227	BPA2227 Read Back is Correct, Report Ready for Departure.	
14:49:00	TWR	BPA2227	BPA2227 RWY35 Cleared for Take Off, Wind 330/10Kts.	
14:49:07	BPA2227	TWR	RWY35 Cleared for Take Off, BPA2227.	
14:50:47	TWR	BPA2227	BPA2227. Contact Approach 133,150, Bye	
14:50:52	BPA2227	TWR	Approach, 133,150, 2227, Bye	
14:50:56	TWR	BPA2227	BPA2227 Why Did you Turn?	
<hr/>				
14:51:00	BPA2227	APP	Approach, BPA2227, Climbing FL180.	
14:51:10	BPA2227	APP	Tirana?! 2227!	
14:51:14	APP	BPA2227	2227, I see you are turning Left to Papiz.	
14:51:19	BPA2227	APP	Sorry, My Mistake, 2227. Now Heading 210.	
14:51:25	APP	BPA2227	2227 Fly to PAPIZ, FL180. ... But you must Turn after Passing 3.000 Feet.	
14:51:31	BPA2227	APP	Yes, Sorry, My Mistake, 2227	

**Fluturimi i dates 07.06.2017**





## SMM INVESTIGATION REPORT

### Investigimi 3/2017 RUNWAY INCURSION

**Investigator:**

Name:			
Unit:	Drejtoria e Safety	Sektori ACC/APP	Drejtoria e Safety
Date:	04.2017	Version:	Final

Ident.		Date:	04.2017	Day:		Aircraft involved:	Yes
ATSR No.:		Time (UTC):	09:51	Time (LT):	11:51		

Aircraft 1:	AAA001	Aircraft 2:	BBB002
Operator:	Blue Panorama	Operator:	Swift Air
Type:	B734	Type:	E120
ADEP/ADES:	LATI/LIMF	ADEP/ADES:	LGTS/LATI
Airspace class:	D	Airspace class:	D
Flight Rules:	IFR	Flight rules:	IFR

ATS Unit:	TWR	Other units involved:	Tirana APP
Type of service:	ADI	Type of service:	APS Radar
Position ( <i>geographic position of incident</i> ): on the Runway			
ACAS/STCA:	N/a		
Other:	N/a	Staffing:	N/a
Traffic numbers:	4	Traffic/Complexity:	High/Normal

MPPTT Order Nr 19	Yes	No	
Date 10.06.2011:			
Category:		Incident	
Severity:		C3	
Frequency of incident:			

## 1. PERSHKRIMI I NGJARJES

Në datën 13.04.2017 afërsisht rreth orës 0951 UTC gjatë uljes së avionit të kompanisë Swift Air me Callsign BBB002 i koordinuar nga njësia e Kullës me njësinë e Approach për t'u ulur me pistën 35 (ndryshe nga pista e deklaruar në përdorim që ishte 17) ndodh një hyrje e paautorizuar në Pistën 17 nga Taxiway E avionit B734 të kompanisë Blue Panorama me Callsign AAA001. Sipas përkufizimit të ICAO-s kjo ngjarje konsiderohet Runway Incursion dhe për të përcaktuar severitetin e saj do të përdorim Skemën e klasifikimit të riskut për Runway Incursion.

Në Kullë po operohej për momentin me dy Kontrollorë, një Tactical dhe një Associate Controller. Supervizori i Kullës nuk ndodhej në Kullë në momentin e ndodhjes së ngjarjes.

Pista në përdorim e përcaktuar nga Kontrollori i kullës ishte Pista 17. Kontrollori i Kullës kishte një avion, BPA2233, që kishte marrë Start-Up me Pistë 17 dhe ndërkohë merr një kërkesë nga Kontrollori i APP se për sa minuta mund të ngrihej Avioni i BPA sepse ai kishte plan të sillte për atrim në 10 min BBB002. Pasi merr përgjigje negative nga ana e Kontrollorit të Kullës sepse Kulla kishte ngritje, Kontrollori i APP bie dakord që sekuenca të vazhdojë me Pistën 17. Ndërkohë Kontrollori i Kullës lejon BPA2233 për taxi në Holding Taxiway E dhe i jep gjithashtu ATC Clearance. Kontrollori i APP merr përsëri Kontrollorin e Kullës (i cili nga e tij i jep informacion se BPA2233 kishte filluar Taxi) dhe i bën përsëri kërkesë për BBB002 që ta sillte me Pistë 35 duke e pyetur gjithashtu Kontrollorin e Kullës nëse kishte avionë të tjerë për Start-Up me Pistë 17. Kontrollori i Kullës nuk i jep info për avionë të tjerë në Start-Up por i kërkon Kontrollorit të APP nëse ka ndonjë kufizim për ngritjen sepse sipas Kontrollorit të Kullës avioni BPA2233 ndodhej në Stand No. 12 dhe donte një kohë prej 2-3 minutash për ngritje. Kontrollori i APP i jep Kontrollorit të Kullës informacion për pozicionin e BBB002 duke i thënë se s'kishte asnjë problem me ngritjen e avionit BPA nga Kulla. Gjatë kohës së ngritjes së BPA2233, kërkon leje për Start me Pistë 17 AAA001 i cili ndodhej në Stand No. 12, si dhe një avion tjetër i të njëjtës kompani, BPA2341.

